



Republika e Kosovës
Republika Kosova – RepublicofKosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

i mbledhjes së katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 22.05.2023,
duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina, kryesues i komitetit, anëtarët e komitetit: Arbnora Berisha, Gëzim Sveçla, Nora Kelmendi, Milazim Vitija, Jeta Rafuna, Donjeta Dragusha, Leutrim Retkoceri, Bahri Gashi dhe Mirsad Vitia.

Mungoi: Shegë Beqiri.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Osman Bllaca, Granit Rugova - drejtor i Drejtorisë së Sportit dhe Adelinë Salihu - drejtoreshë e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fehmi Kupina kryesues i komitetit, i cili paraqiti këtë

REND DITE

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozimi i Projekt-statutit i Poliklinikës Stomatologjike;
3. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve klubit futbollistik të volejbollit „Prishtina” - femrat;
4. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare klubit të basketbollit „Sigal Prishtina”;
5. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare klubit të basketballit të femrave „Prishtina”;
6. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare të klubit të futsallit – FC „Prishtina 01”;
7. Propozimvendimi përndarjen e mjeteve financiare të klubit të hendbollit – femrat KHF „Prishtina 1957”;
8. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare klubit të hendbollit „Prishtina”- meshkujt;
9. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare klubit të volejbollit „Prishtina”;
10. Raport vjetor i punës për vitin 2022, i ndërmarrjes publike „Kuzhina Qendrore”, SHA;
11. Raport vjetor i punës për vitin 2022, i ndërmarrjes publike „Prishtina Parking”, SHA;

Faqe 1 nga 6

**12. Raport vjetor i punës për vitin 2022, i ndërmarrjes publike „Hortikultura”, SHA;
13. Të ndryshme.**

Para së të fillonin me diskutimet për pikat e rendit të ditës, Adelinë Salihu propozoi që të hyjë si pikë e rendit të ditës mbështetja financiare për dy familje strehuese që kanë nga një fëmijë me aftësi të kufizuar dhe kanë arritur moshën 18 vjeçare, duke shtuar se deri më tani ministria i ka paguar në shumën 350 euro këto familje që kujdesen për këta fëmijë. Çfarë duhet të bëjmë ne si Kuvend në këtë rast, është që t'i mbështesim në shumën prej 5000 euro në vit për njëren familje, kështu që i bie 10 mijë euro për të dyja. Ne si drejtori i kemi shumat të cilat mund t'i mbështesim, mirëpo po bëhet fjalë për një shumë të madhe dhe duhet ta kemi votimin e asamblesë. Për të dhënët tjera në lidhje me këtë propozim për këta dy fëmijë, ne do ta përgatisim një vendim dhe po besoj që brenda ditës ose nesër më së largu Zyra ligjore e përcjell tek ne, pastaj ne tek ju, për të parë emrat e familjarëve, emrat e fëmijëve dhe të dhënët e tyre bazike.

Gëzim Sveçla: - tha se ne jemi përfaqësues të grupeve të asamblistëve, unë po flas në emër të grupit tim, ne kemi mbajtur një qëndrim prej grupit, që kemi thënë të mos votojmë më pika të rendit të ditës kur sillen në KPF një ditë përpara. A ka mundësi këtë kërkesë për propozim ta bëni në fillim të seancës, sepse nuk dua ta thyej atë qëndrimin e grupit, e në anën tjetër është një rast i ndjeshëm që unë mendoj që duhet të kalojë.

Fehmi Kupina, kryesues: - tha se jemi dakorduar që në KPF mos të sillni pika të reja, në seancë edhe unë do ta përkrah.

Gëzim Sveçla: - sugjeroi drejtoreshën që këto pika që vijnë para seancës së bashku me materiale, kështu që t'i shtypni 51 materiale që të na i shpërndani të gjithëve, ndoshta bëhet shembull i mirë për të tjerët.

Adelina Sahiti: - tha se do t'i marrë përbazë sugjerimet e juaja.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit i mbledhjes së tretë i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dytë

Propozimi i Projekt-statusit të Poliklinikës Stomatologjike

Fehmi Kupina, kryesues: - për këtë pikë të rendit të ditës, tha se drejtori nuk është këtu.

Anëtarët kerkuan që të hedhet në votim që kjo pikë të largohet nga rendi i ditës, pasi që asnjë përfaqësues nga drejtoria nuk është për ta prezantuar propozimin.

Me shumicë votash u miratua që të largohet kjo pikë nga rendi i ditës.

Gëzim Sveçla: - kerkoi që pikat 3,4,5,6,7,8 dhe 9 të lidhen të gjitha.

Pika e tretë

Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve klubit futballistik të volejbollit „Prishtina”- femrat

Pika e katërt

Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare klubit të basketballit „Sigal Prishtina”

Faqe2nga6

Pika e pestë

Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare klubit të basketbollit të femrave „Prishtina”

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare të klubit të futsalit –FC „Prishtina 01”

Pika e shtatë

Propozimvendimi përndarjen e mjeteve financiare të klubit të hendballit – femrat KHF „Prishtina 1957”

Pika e tetë

Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare klubit të hendballit „Prishtina” - meshkujt

Pika e nëntë

Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare klubit të volejbollit „Prishtina”

Granit Rugova: - tha se dokumentacionin që e keni kërkuar ua kemi dërguar komplet dhe besoj që ecim tutje.

Nora Kelmendi: - tha se e kam një pyetje për z. Kçira, por nuk qenka këtu, dua ta di se këto subvencione përsë nuk i ndani në bazë të rregullores në fuqi që është për ndarjen e subvencioneve, por i ndani në bazë të kërkesave të klubeve të ndryshme. I kam shikuar të gjitha kërkesat, prej klubit të volejbollit e deri në fund, i kam shikuar edhe shpenzimet, ju kanë mashtruar, pagesat janë të majme për ushqim etj., e mos të flasim për gjëra tjera. A e dini që rregullorja ekziston, duhet të bëhet një shpallje, thirrje për subvencionim etj.

Granit Rugova: - tha se po flet për pjesën sportive, bëhet thirrja prej Drejtorisë së Sportit, që është për të gjitha klubet, tek thirrja është një limit, d.m.th. është një 2% e maksimumit të thirrjes. Këto klube janë më të veçuara, klube më të vjetra dhe klube që i kanë shpenzimet pak më të mëdha se klubet tjera, këto duhet të përkrahen përmes Kuvendit, përndryshe të gjitha klubet tjera aplikojnë në subvencionet e Drejtorisë së Sportit dhe përkrahen 98% prej tyre. Në fund tha se sa i përket pjesës së shpenzimeve, klubi ka shpenzime më të mëdha se që ne mund t'i imagjinojmë.

Nora Kelmendi: - lidhur me shpenzimet ajo tha se nuk figuron një muaj, njëherë figuron katër muaj, pastaj një muaj, e pastaj prapë edhe një muaj nga 2672 euro, 2630 euro, 1041 euro etj., nuk po hy në detaje. Po ashtu tha se këto shpenzime që ua kanë sjellë me E-banking, asgjë nuk pasqyrojnë.

Granit Rugova: - tha se këtë vit një klub do të përkrahet vetëm njëherë, qoftë prej Kuvendit, qoftë prej Drejtorisë së Sportit. Tutje tha se më mirë është ta shkruani me E-banking sesa ta sillni një faturë, një paragon apo diçka tjetër.

Gëzim Sveçla: - tha se kur ta sillni faturën e rregullt është në rregull. Klubi basketballistik „Prishtina” i ka sjellë pagat. d.m.th i kemi subvencionuar pagat, nuk guxojmë t'i subvencionojmë pagat, është rregulloja që thotë se ne sponsorizojmë aktivitete, organizime dhe mbarëvajtje të garave.

Granit Rugova: - tha edhe ai është shpenzim i klubit edhe paga është për mbarëvajtje të ligës, ata lojtarë pa i paguar nuk mund ta zhvillosh ndeshjen.

Gëzim Sveçla: - tha se edhe në raport të auditimit është përmendur ndarja e këtyre subvencioneve, mënyra se si ndahen nuk është në rregull, duhet vetëm të kérkon përgjegjësi për para të cilat i jepni.

Granit Rugova: - tha, çdo klub i ka politikat, formën e funksionimit, shpenzimet dhe ato që janë të figuruara aty, janë një pjesë shumë e vogël e shpenzimeve që i ka klubin, sepse ka edhe shpenzime të tjera shumë më të mëdha.

Osman Bllaca: - dha sqarime në lidhje me raportimin që bëhet, çdo OJQ kur përkrahet, para se me e mbështetë ne financiarisht, u kërkohet atyre se çfarë do të bëjnë dhe në fund e kanë buxhetin të cilin do të na sjellin ata, kurse ne i tregojmë të gjitha linjat buxhetore se për çfarë do t'i shpenzojnë, nuk lejohen të shpenzohen në linja të tjera përvëç buxhetit se si e kanë sjellë ata.

Nora Kelmendi: - tha se kërkesat që i kanë sjellë, i kanë bashkëngjitur disa fatura dhe kanë sjellë kërkesa për aktivitete të ndryshme që e tejkalojnë shumën e këtyre 50 mijë eurove.

Granit Rugova: - tha se ne po u ndihmojmë, ata i kanë shpenzimet shumë më të mëdha, ne si Komunë në një pjesë po u ndihmojmë.

Gëzim Sveçla: - tha, më mirë ta shikojmë aspektin ligjor, nëse e marrim aprovimin që është në rregull, është në rregull, por nëse na thuhet që nuk është në rregull, ne nuk mund ta votojmë.

Donjeta Dragusha: - pyeti drejtorin se në material ishin disa shpenzime të detajuara, por e pasq një standard të dyfishtë, disa klube e kanë bashkëngjitur një vërtetim që nuk kanë borxhe të tatimit, ndërsa një klub e ka bashkëngjitur një tabelë ku ka shumë borxh të tatimit. Në fund pyeti se a kanë ndonjë përparsi këto klube që nuk kanë borxhe, a ka ndonjë kriter.

Granit Rugova: - shtoi se në parim duhet mos të kenë borxh. Është "Sigal Prishtina" që ka borxh, por e ka bërë marrëveshjen për ta paguar, pasi që e kanë bërë marrëveshjen t'i kthejnë me këste është në rregull.

Bahri Gashi: - tha se po pajtohem me drejtoreshën, mirë do të kishte qenë secili klub ta ketë raportin me vulë e jo të E-banking. Po ashtu ai paraqiti si shqetësim têrheqjen e 27 mijë eurove prej llogarisë bankare, duke shtuar se ka qenë mirë të bëhet pagesa e shpenzimeve e jo têrheqje e parave kesh, në ç'rast kërkoi sqarim se kur kërkojnë para duhet të jenë më të kujdesshëm, duhet të dimë pse janë têrhequr ato para, dhe kjo të merret si vërejtje për ata.

Kryesuesi konstatoi se u përkrahën:

- Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare klubit të volejbollit „Prishtina”- femrat;
- Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare klubit të basketbollit „Sigal Prishtina”;
- Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare klubit të basketbollit të femrave „Prishtina”;
- Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare të klubit të futsallit –FC „Prishtina 01”;
- Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare të klubit të hendbollit – femrat KHF „Prishtina 1957”;
- Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare klubit të hendbollit „Prishtina” – meshkujt, dhe
- Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare klubit të volejbollit „Prishtina”
Këto propozimvendime dërgohen në Kuvend për miratim.

Pika e dhjetë

Raporti vjetor i punës për vitin 2022, i ndërmarrjes publike „Kuzhina Qendrore”, SHA

Fehmi Kupina: - tha se edhe për këtë pikë nuk është këtu askush që mund të flas, duke shtuar se nuk i ka ftuar, për arsyse se aty nuk ka debat për atë pikë dhe mbetet të vinë për seancë.

Osman Bllaca: - tha, në KPF nuk po ka debat për ndërmarrje, zakonisht po rezervoheni për Kuvend.

Mirsad Vitija: - tha se për ndërmarrje duhet me qenë edhe një drejtor aksionar i kësaj ndërmarrjeje.

Fehmi Kupina: - tha se nuk e di kënd do ta dërgojnë ata, unë u kam dërguar email për seancë edhe kryesuesve edhe shefave, nuk e dimë se kush do të prezantojë.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Raporti vjetor i punës për vitin 2022, i ndërmarrjes publike „Kuzhina Qendrore”, SHA dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.

Pika e njëmbëdhjetë

Raport vjetor i punës për vitin 2022, i ndërmarrjes publike „Prishtina Parking”, SHA;

Fehmi Kupina, kryesues: - tha se njëjta çështje është edhe kjo, edhe këtu merren vesh ata se kush vjen.

Bahri Gashi: - tha se aksionarët e kanë obligim të mbledhin informata dhe ta lexojnë raportin, jo kryeshefi.

Osman Bllaca: - tha ai është raport i punës, edhe menaxhmenti e harton raportin.

Bahri Gashi: - tha se raporti financiar nënkupton detajet e shpenzimeve të të hyrave ku kanë shkuar paratë, në cilën kompani kanë shkuar paratë, kush është përfituesi dhe me çfarë procedure është ai fituesi e jo pasqyrat financiare. Pasqyrat financiare, kur të vjen Administrata Tatimore në kontroll as nuk i merr për bazë.

Fehmi Kupina: - tha aty nuk shkruan raport financiar, por shkruan vetëm Raporti i ndërmarrjes.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Raporti vjetor i punës për vitin 2022, i ndërmarrjes publike „Prishtina Parking”, SHA dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.

Pika e dymbëdhjetë

Raport vjetor i punës për vitin 2022, i ndërmarrjes publike „Hortikultura”, SHA;

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Raporti vjetor i punës për vitin 2022, i ndërmarrjes publike „Hortikultura”, SHA dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.

Të ndryshme

Gëzim Sveçla: - kërkoi që pauzën ta bëjnë në ora 13:00 për Kuvend, sepse kur po dalin në ora 12:00, të gjitha kafenetë po janë të zëna dhe për atë arsyse edhe po vonohemi pastaj në vazhdimin e seancës.

Faqe5nga6

Leutrim Retkoceri: - informoi se një material për Demostratat e 81-tës, është duke u përgatitur, po shkon gjatë, ka gjasë që nëse nuk kompletohet dokumentacioni në seancën që unë i propozoj materialet, i kemi dërguar ta bëjnë vetëm vendimin për ndarje të lokacionit. Aty është i përfshirë edhe vendimi për ndarje të lokacionit që na përket neve si Kuvend, por është edhe një plan se si do të duket pllaka që i dedikohet Demostratave të vitit 1982 dhe nëse përgatitet në detaje ai plan, do të kishte qenë mirë ta ketë edhe Kuvendi në mënyrë që ta shohim se çfarë do të bëhet. Pastaj tha se nëse nuk përgatitet, unë do kisha thënë ta propozojmë lokacionin, sepse edhe ashtu MAPL i merr një muaj ditë kohë, dhe të paktën deri në tetor le të jetë gati si projekt.

Gëzim Sveçla: - pyeti për kur është, a është për tetor.

Leutrim Retkoceri: - tha, për tetor duhet të ekzekutohet komplet.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

Procesmbajtësja:
Shyrete Islami

Kryesues i Komitetit
Fehmi Kupina



Faqe6nga6